



**UNIVERSITETI I PRIZRENIT**

UNIVERSITY OF PRIZREN

„Ukshin Hoti“

**Rektorati**

---

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

---

**Nr. i ref. 01-\_\_\_\_\_ Prizren, më \_\_\_\_\_**

---

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr. 04/I-037, si dhe dispozitat e nenit 47 paragrafi 1.3 të Statutit, Senati i UPZ-së në mbledhjen e mbajtur më datë 24.12.2014, merr vendim me nr. 01-1986 për të:

shpallur

## **KONKURS**

**(i korrigjuar i datës 29.12.2014)**

**për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e Universitetit të Prizrenit**

### **I. FAKULTETI JURIDIK**

- 1. Një mësimdhënës për lëndët:** Historia e Shtetit Shqiptar dhe së Drejtës, (Historia e Shtetit dhe së Drejtës në përgjithësi dhe veçanti e shtetit shqiptar), dhe E Drejta Humanitare Ndërkombëtare.
- 2. Një mësimdhënës për lëndët:** E Drejta Civile, E Drejta Civile Procedurale I, (E Drejta e Procedurës civile pjesa kontestimore).
- 3. Një mësimdhënës për lëndët:** E Drejta Ndërkombëtare Private, E Drejta Penale Ndërkombëtare.

### **II. FAKULTETI EKONOMIK**

- 1. Një mësimdhënës për lëndët:** Matematika dhe Statistika
- 2. Një mësimdhënës për lëndët:** E drejta Biznesore dhe Ligjet e Kompanive

### **III. FAKULTETI I EDUKIMIT**

**Në Programin në gjuhën mësimore shqipe**

- 1. Një mësimdhënës për lëndët pedagogjike.**

## Në Programin në gjuhën mësimore turke

1. **Një mësimdhënës për:** gjuhën turke, Gjuhë amtare turke I dhe II.

## Në Programin në gjuhën mësimore boshnjake

- 1 **Një mësimdhënës për:** gjuhë boshnjake I dhe II,
- 2 **Një mësimdhënës:** të matematikës I dhe II,
- 3 **Një mësimdhënës për:** grup lëndësh pedagogjike.

## IV. FAKULTETI I FILOLOGJISË

1. **Një mësimdhënës për lëndët:** Gjuhë e sotme gjermane, Morfologji e gjuhës gjermane, Sintaksë e gjuhës gjermane, Metodika dhe didaktika e gjuhës gjermane.
2. **Një asistent/e për:** grup lëndësh të gramatikës së gjuhës gjermane.

## V. FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

1. **Një mësimdhënës për lëndët:** Sistemet e Databazave, Databazë e Avancuar, Zhvillim Softueri 1, Zhvillim Softueri 2.
2. **Një asistenti për lëndët:** Grup lëndësh nga fusha e Programimit dhe e Bazave të të Dhënave.
3. **Një asistenti për lëndët :** Grup lëndësh nga fusha e Rrjetave dhe Sigurisë në IT.

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e **Statutit të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”**.

1. **Për vendin e punës mësimdhënës,** kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoraturën në lëmin përkatëse.
2. **Për vendin e punës asistent,** kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar studimet Master në lëmin përkatës dhe të jetë i regjistruar në doktoraturë (PhD) dhe të mos ketë më shumë se 28 vjet.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t’i paraqesin këto dokumente: ***kërkesën me biografi (CV), kopjen e diplomës së kualifikimit përkatëse të kërkuar si në pikën 1 dhe 2, të noterizuar (vërtetuar), certifikatën e lindjes, certifikatën e shtetësisë, ndërsa ata të cilët janë të punësuar në Fakultet tjera publike, duhet ta paraqesin edhe vendimin e zgjedhjes së fundit, dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale, si dhe informatat e tjera specifike***

***shtesë, të cilat janë të rëndësishme për ata që aplikojnë. Për vendin e punës asistent, kandidatet duhet të sjellin edhe certifikatën e notave për studimet Bachelor dhe Master.***

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët. Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet Bachelor apo Master jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i.

***Përparësi në pranim do kenë kandidatët më shtetësi Kosovare.***

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në gazetë, respektivisht deri më datën 12.01.2015 në orën 16.00.

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Zyrën e Protokollimit në Rektorat në UPZ, nr. 308. Kopja elektronike e dokumenteve duhet të dërgohet edhe në e-mail-in zyrtar të UPZ-së: [rektorati@uni-prizren.com](mailto:rektorati@uni-prizren.com).

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara – të pa nostrifikuara nga MASHT, nuk do të pranohen - nuk merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit në këtë adresë: **<http://www.uni-prizren.com>**